



Grant Thornton

An instinct for growth™

Pasqyrat financiare

Akademia Profesionale e Biznesit Sh.p.k

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015



Grant Thornton

An instinct for growth™

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D, Shk. B,
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtimin e Akademia Profesionale te Bisnesit Sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Akademise Profesionale te Bisnesit Sh.p.k (“Shoqëria”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsiderate kontrollin e brendshëm të Shoqërisë mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të Shoqërisë, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë, më 31 dhjetor 2015, dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Grant Thornton sh.p.k.

Kledian Kodra, FCCA
Kodra

Tiranë, Shqipëri
13 Prill 2016

